



2016

RAPORT- TM₁ -2016



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com


PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME	5
II. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	6
2.1 Aktivitetet – Janar-Mars 2016	6
2.2 Prodhimi i ujit m ³	9
2.3 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	10
2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim	10
2.5 Servisimi I ujëmatësave	12
2.6 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	12
2.7 Raport per trajtimin e ujërave te zeza	16
III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	22
3.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	22
3.2 Aktivitetet e shërbimit te kontrolles	22
3.3 Pengesat ne realizimin e objektivave	23
3.4 Masat e realizuara	23
3.5 Planet për të ardhmen	24
3.6 Raport I mediave	24
IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	31
4.1.1 Aktivitetet – Janar-Mars 2016	31
4.1.2 Personeli	32
4.1.3 Raport I puneve te kryera nga gjykatat	33
V. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR	36
5.1 Aktivitetet – Janar-Mars 2016	36
5.2 Shpenzimet – Janar-Mars 2016	37
VI. RAPORT I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT	38

VII. RAPORT I AUDITORIT TE MBRENDHEM	39
---	-----------

VIII. RAPORT I PERFORMANCAVE OPERATVE DHE FINANCIARE TM1-2016	40
--	-----------

ORGANOGRAMI

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME

FURNIZIMI

Furnizimi me uje te pijes ne nivel regjional ka qene i rregullt, neper te gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë. Kompania është angazhuar dhe ka arritur që në TM-1 të vitit 2016 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku edhe kemi reduktime (kryesisht të lagja Dardanisë, pjesa e Bazhdarhanës dhe në rrugën e Janinës). Në njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme me furnizim më ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e njesive operuese kemi patur furnizim të rregullët me ujë të pijes.

UJI I PRODHUAR

Për muajin TM-1, 2016 në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **3,973,219.00 m3**, krahasuar me TM-4, 2015 kemi një zvoglim të prodhimit të ujit të pijes prej **96,920.00 m3**. Jane duke vazhduar aktivitetet për të mbajtur gjendjen stabile të furnizimit me ujë.

FATURIMI

Në periudhën e TM1 - 2016 janë faturuar 1.676.096 m3, apo 0.73% më shumë se në TM1-2015
Faturimi në Euro në TM1- 2016 ka qenë 989.546,36 €, në krahasim me TM1 - 2015 ka pas një rritje prej 1.28%

INKASIMI

Në periudhën e TM1 -2016 janë inkasuar 729.307,75€ , apo 13.40% më shumë se në periudhën TM1 -2015.
Përqindja e inkasimit ishte 74.73% ose 8.22% më e lartë se në periudhën TM1 - 2015

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se.
Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi.
Shërbimi Teknik me të gjithë sektoret e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e defekteve sa më shpejtë.
Raportet tregojne që UPF në nivel regjional për muajt Janar-Mars 2016 është **57,80** ose **0.02%** me zvoglim të UPF-së nga TM1 paraprak.

SHPENZIMET

Shpenzimet në periudhën e TM1- 2016 rrinë në 818,336.80 € apo 8.40% më të ulta se në periudhën TM1 -2015.

MBULIMI OPERATIV

Për periudhën TM1- 2016 kompania kishte mbulim operativ negativ prej 0.86 (-89.029,05€)– (TM1-2015 – 0.72 - (-250,274.62€)), një dallim prej +0.17.

II. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

2.1 Aktivitetet - Janar-Mars – 2016

- *Pergaditja e listes se projekteve nder vite, per Plan Biznesin 2016-2018
- *Dergimi i raportit per humbjet e ujirt dhe investimet ne zvogelimin e humbjeve per Qamil Musen-ZRRUK, te kerkuara nga Komisioni Evropian.
- *Perpilimi i raportit per muajin 12/2015 dhe pergaditja e raportit per TM3-2015
- *Takime Javore me Konsulencen per progresin e punimeve per projektin e Ujerave te Zeza
- *Eshte pergaditur dhe dorezuar paramasa per Hidranta ne Komunen e Prizrenit,
- *Pergaditja e dokumentacionit per nxjerrjen e pelqimeve ujore ne MMPH
- *Takim me zyrtaret Komunal, per nxjerrjen e Kontos se mirebesimit
- *Takim me menaxhmentin e Kompanise
- Dergimi i kerkeses per NO OBJECTION ne KfW per projektin e asistences Teknike
- *Pergaditja e kerkesave per lejen per projektin e ujerave te zeza
- *Kerkesa te vazhdueshme per leshimin e lejes per prjektin e MZHE-se
- *Takim me AQUALIA per pergaditjen e dokumentacionit per VNM dhe per leje ndertimore ne MMPH
- *Kontakte te vazhdueshme me Komunen e Prizrenit per ecurine e shpronesimit te likacionit per ITUZ
- *Takim me Zoge Spahiu dhe Vera Muhaxheri.
- *Takim me Kryeshefin Ekzekutiv ne lidhje me mundesin e informimit te konsulences dhe KfW per nderrimin e gypit transportues te ujesjellesit te lokacioni Ura e Marashit
- *Diskutim lidhur me donacionin qe pritet te jepet nga MMPH
- *Kontakt me Fejsal Hotin , ne DSHP, ku u sqarua se parat jane te gatshme te vendosen ne llogarin e mirebesimit por pritet nje vendim nga Kryetari I Komunes dhe menjeher do te transferohen ne kete llogari.
- *Marrje e para pelqimit ne Drejtorin e Urbanizmit I cili ka te beje me faktin se lokacioni ku do te ndertohet ITUZ-ja nuk bie ndesh me planin zhvellimor rregullativ.
- *Takim me Drejtorin e Bujqesis per shkak te ekstraktit qe kjo toke nuk eshte e destinuar per bujqesi, dhe me paraqitjen e pelqimit nga Drejtoria e Urbanizmit, Drejtori I Bujqesis tha qe ky document nuk ju nevoitet
- *U more pelqimi nga PTK-ja per projektin e ujrave te zeza
- *Dergimi I dokumenteve te duhura ne MMPH perms Afrim Demirit per pelqimin e DHNM.
- *Pergaditja e dokumentacionit per takim me KfW I cili do te mbahet me 10.02.2016
- *Informim te zyra konsulente – Kadri Selimaj per takimin qe do te kemi me delegacionin *Gjerman me qrast do te dalin ne vendin e punimeve. Kompania konsulente u informua qe te pergaditet per takimin me delegacionit.
- *Takim me Liman Gashin per sqarimin e KfW ne lidhje me kontraten e veqant e cila ka te beje me mjetet e TVSH-se per pagesat qe I kemi pasur nga MMPH per projektin e ujerave te zeza.

- *Takim me Kompanin ELKOS per dhenje te pelqimit, ku une si department teknik do te kerkoj miratim nga menagjmenti I kompanis per dhenje te keti pelqimi per kompanin ELKOS, te cilet kane bere kerkese per tri projekte kurse kerkoj dhenjen e pelqimit vetem per njerin prej tyre.
 - *Kerkesa per lirim nga pagesa e VNM-se ne MMPH,
 - *Takim me KfW-ne me Karl KUmer per njoftimin e zevdesit te ytije me rastin e daljes ne pension dhe njoftimi me ecurine e punimeve si dhe dalja ne teren ne vendet ku jane duke u zhvilluar punimet.
 - *Takim ne MZHE me Limanin, ku u dorezua kerkesa per subvencionimin e shpenzimeve per djegje te objektit.
 - *Takim ne MMPH me Limanin, dorezimi i VNM-se dhe takimi me Arben Citakun
 - *Takim ne Hotel SRIUS per seminarin me JICA, prezantimi i planeve te veprimit dhe rumbullakimi perfundimtar i tri trajnimeve per Ujerat e zeza ne JAPONI.
 - *Dalje ne teren ku jane duke u zhvilluar punimet per fazen I dhe II te projektit te ujerave te zeza
 - *Dergimi i kerkeses per NO OBJECTION ne KfW me ndryshime, ku eshte perjashtuar *HOLINGER per shkak te voneses se dorezimit te ofertes.
 - *Takime javore me konsulencen per progresin e puneve per Fazen 1 dhe 2.
 - *Takim me Konsulencen dhe AQUALINE per dokuemntet e nevojshme shtese per nxjerrjen e lejes ne MMPH
 - *Nxjerrja e te gjitha pelqimeve te nevojshme nga ana jone, qe nevojiten per marrjen e lejes se ndertimit pran MMPH, per projektin e ITUZ-se
 - *Takim ne AKK, per sqarimet shtese per menyren e Deklarimit vjetor te pasurise ne AKK
 - *Njoftimi me shkrim permes postes elektronike Kryetari i Komunes, kryetari i kuvendit, drejtori i DSHP-se per plotesimin e Kontos se mirebesimit, kusht per nxjerrjen e lejes se ndertimit ne MMPH.
 - *Bisede permes telefonit me Krtetarin e Kuvendit te prizrenit per gjendjen e bartjes se mjeteve ne konton e mirebesimit
 - *Korespondencat elektronike me KfW-, Konsulencen dhe Kontraktoret per projektin e ujerave te zeza.
 - *Takim me kryetarin e kuvendit ku i eshte sqaruar rendesia dhe pasojat qe munde ti kemi nese nuk plotesohet kushti per bartjen e mjeteve ne konton e mirebesimit per shprinesimin e lokacionit te ITUZ-se
 - *Dalje ne vendin e punimeve tek MARASHI ku eshte duke u implementuar projekti i FAzes 1 -kolektori dhe kaperderdhsat.
 - *Pergaditja dhe dorezimi i planit te investimeve per vitin 2016-2018
 - *Dorezimi i listes se zyrtareve te larte ne AKK
 - *Mbledhja e menaxhmentin e kompanise, shqyrtimii performances per muajin Janar
 - *Dalje ne teren krisje ne gypin O100, tek projekti i ujerave te zeza.
 - *Kontakt telefonik me Kryetarin e asamblese ne Prizren dhe me koordinatorin e DSHP-se, per bartjen e mjeteve ne Konton e Mirebesimit
 - *Pjesemarrje ne hapjen e ofertave per Eficience te Energjise projekti i KfW-se
 - *Takim me Ulrihun-Konsulencen per disa pika me rendesi per projektin, si shpronesimi, Kontoja e vecant, etj.
 - *Sqhyrtimii kerkeses se Shkolles teknike per kryerjen e praktikës per nxenesit ujesjelles dhe kanalizim si dhe miratimi nga drejtoria.
- 29.02.2016
- *Dergimi i sqarimit per Elke Dulenkopf per bartjen e mjeteve ne Llogarine e mirebesimit
 - *Takim me KFOR-in Gjerman, ku u diksutua rreth furnizimit me uje te pijes, u sqaruan ecurite e projekteve, si dhe u be kerkesa per kycjen e nje pjese te rruges ne Kurille.
 - *Kerkesa nga studentet e UBT-se, per mundesine e majtjeve ne Galerine II.
 - * Takim me Ali Palushin per zgjatjen e pelqimit per kycje ne rruge lokale nga DPSH ne Prizren si dhe kthimi i klases se tokes ne Ministrine e Bujqesise.
 - *Takim me Kwe dhe Drejtorine e Sherbimeve Publike
 - *Takim me Brayarin per menaxhimin e thatesirave
 - *Takim me Kompanine Turke per vendosjen e ujematsave nga largesia.
 - *Hapja e ofertave financiare per projektin e asistences teknike.

- *Takim me Komunen, Konsulencen, Kontraktorin ne lidhje me mbarevajtjen e punimeve dhe planin e punimeve ne pjesen e qytetit ku do te vendoset kolektori dhe kaperderdhesat,
- *Dergimi dhe njoftimi i Klaus Rothe per hapjen e dhe evaluimin e ofertave financiare per projektin e asistences teknike.
- *Dalje ne vendin e punimeve te CSO1a te rrethi Hoqes me rastin e kaperderdhjes se pusetes ne rruge per shkak te reshjeve te shiut.
- *Dergimi i draft raportit te evaluimit te pjeses financiare nga ana e Klaus Rothe,
- *Dalja ne vendin e punimeve te kolektorit perpjesen e pare.
- *Takim me banoret e lagjes Ralin per qeshtjen e vershimeve, ku u konstatua se hyrja e ujit te shiut neper podrume ska te beje fare me projektin, mbete te mendohet ne interv. e kanalizimit.
- *Kompletimi dhe Dergimi i IPC3 per fazen 1, per pagesen e Passavente,
- *Takim javor per projektin e kolektorit te ujerave te zeza.
- *Matjet gjeodezike ne teren per piketimin e rretit ekzisutues te ujesjellesit ne rrugen R. Ademaj.
- *Takim me Drejtorine e Sherbimeve Publike-Paraqitja e projektit kryesor per rrugen Remzi Ademaj per projektin e kolektorit te ujerave te zeza. U paraqit kerkesa per pelqim per fillimin e punimeve, ku dhe u ra dakort qe me 24.03.2016 te bllokoget rruga dhe te fillojne punimet ne kete seksion- Komune-Therande rreth 500m.
- *Vizite ne teren pergaditjet per fillimin e punimeve ne rrugen Remzi Ademaj.
- *Evaluimi i pjeses financiare nga Komisioni i KRU HRJ per projektin e asistences teknike per ujerat e zeza - WWTP.
- *Perpilimi i komenteve dhe shqetesimeve tona per projektin easistences teknike per U.Z-WWTP
- *Takim me Premtim Islamin per projektin e ujerav ete zeza, ku u diskutuar, kontoja e vecant per bartjen e mjeteve qe jane rimbursuar nga ATK-ja per TVSH-ne.
- *Njopftimi nga Komuna per transferimin e mjeteve per shpronesim ne llogarine e mirebesimit.
- *Dergimi i njoftimit per bartjen e mjeteve tek KfW dhe te gjithë pjesemarrësit ne projektin e ujeave te zeza
- *Dergimi i komenteve dhe shqetesimeve tona per projektin e asistences teknike
- *Takim ne Prishtine me rastin e shenimit te Dites se Ujerave ne MMPH.
- *Takim me Konsulencen ku dhe u nenshkruan dhe u vertetuan ndryshimet ne linjen e kanalizimit dhe kaperderdhesit.
- *Fillimi i punimeve ne seksionin Komune-Hotel Theranda ne rrugen Remzi Ademi,
- *Dalje ne vendin e punimeve me crast dhe u sqaruan te gjitha te dhenat teknike, me kete rast ka pelcitur gypi 1" ku dhe eshte riparuar perkohesisht pasi qe nuk furnizonte asnje konsumator por supozohej se ishte gyp per ujitjen e bimeve per rreth rruges.
- *Takim pune me te gjith inxhinieret e kompanise per projektin e Eficiences Elektrike.
- *Shenimi i Dites se Ujervae takim ne Sharr-Prevalle, te ftuar Te gjitha organet relevante te ujit dhe donatoret e jashtem.
- *Ligjerate per nxenesit e shkolles Ekonomike,
- *Njofitimi ne MMPH per mbajtjen e Debatit Publik per VNM me qytetaret e Prizrenit
- *Diskutim telefonik me Zyrтарin e Prones ne Drjetorin e Administrates per kthimin e tokes ne emer te komunes dhe kontraten per shfrytezim nga ana e HRJ-se.
- *Dorezimi i Formulareve te Deklarimit te Pasurise ne AKK.
- *Dalje ne vendpunishte tek projekti i kolektorit,
- *Takim me Hasan Hasanin te zyrja e Shefkatis ku u diskutuae per ecurin e punimeve dhe e pyeta per dokumentin e shpronesimit i cili duhet te kaloje mbi komunën, ai me tha qe brenda kesaje jave do te bartet pronesia mbi komunën.
- *Dergimi i miratimit tek Klaus Rothe per zgjatjen e vleshmerise se ofertave per Masat Shoqeruese, deri me 30.06.2016.
- *Dergimi i konfirmimit per ndrrimin e gypave tek bajpasi per kundra ramje i ujerave te shiut.
- *Pergjigje per konsulencen per Ulrihun ne lidhje me shpronesimin,
- *Dalje Lumi me Urimin tek vendpunishtja e kolektorit Faza I.
- *Aplikimi per pjesemarrje ne konferencen e ujerave Danubi, 11 dhe 12 Maj 2016.

*Takim me Kryeshefin per mundesine e formimit te komisionit per riorganizimin dhe rishqyrtimin e organogramit. Une i dergova emrat tek Departamenti i administrates tek Kadri Zogaj.

*Takim me Fadil Berishen per raportin vjetor qe do te dergohet ne ZRRUK,

*Dalje ne vendin ku jane duke u zhvilluar punimet ne Kolektorin e UZ Faza 1,

*U konstatua se duhet te ndrrohen rreth 24 m gyp ne rrugen Remzi Ademaj aty ku jane duke u zhvilluar punimet, me kete rast kontraktori permes nje emaili ka pranuar defektin dhe eshte ne gjendje ta kompenzoj.

*Takim me Konsulencen, ku dhe u vendos qe kolektori te punohet ne linjejen ekzistuese dhe paralel me punimet te behet edhe ndrrimi i gypit te ujesjellesit O160 me crast ne si kompani do te realizojme vetem punimet e kyceve per konsumator dhe do te punojme gypin e ri me te gjitah fazenorite percjellese.

*Në muajt Janar-Mars 2016, është bërë leximi i ujëmatësve zonal me qellim për të verifikuar hargjimet e ujit nëpër zonat e veçanta.

(Për me gjerësisht ekziston raporti të Kordinatori për Planifikim dhe Zhvillim).

*Aktivitete e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eleminimin e hubmjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjellesit dhe ndarja e zanave per dedektim.
- ✚ Senzibilizimin e te gjithe konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara.
- ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjithe konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

2.2 PRODHIMI I UJIT m³, TM4 -2014 – TM1-2015

TM1 -2015

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,067,442.00	34,082.69	394.5	
Suharekë	463,186.00	5,146.51	59.6	
Dragash	93,010.00	1,033.44	12.0	
Malishevë	321,563.00	3,572.92	41.4	
Total	3,945,201.00	43,835.57	507.4	

TM1 -2016

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,108,200.00	34,156.04	395.3	
Suharekë	450,948.00	4,955.47	57.4	
Dragash	69,300.00	761.54	8.8	
Malishevë	344,771.00	3,788.69	43.9	
Total	3,973,219.00	43,661.75	505.3	

2.3 MIRËMBAJTJA E RRJETIT – SANIMI I DEFEKTEVE,

TM1 2015

Njësia Operative	Ujësjiellësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	233	132	365
Suharekë	87	19	106
Dragash	06	01	07
Malishevë	81	16	97
Total	407	168	575

TM1 2016

Njësia Operative	Ujësjiellësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	214	141	355
Suharekë	73	35	108
Dragash	15	03	18
Malishevë	83	12	95
Total	385	191	576

2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim – TM1-2016

Për periudhen që po raportojmë në kuader të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar bllobimet e ujëmatësive nëpër qytetin e Prizren'it, në hartat: 7E122009, 7E123009, 7E123008, 7E123005, 7F121111 ku kanë arritur këto rezultate:

- Ujëmatësa të bllobuar 391 Ujëmatësa.
- Kontrata të nënshkruar 391 Kontrata.
- Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 526 konsumator.
- Ribllobim, bllobim për herë të dytë 275.
- Konsumatorët pa ujëmatës 36.
- Konsumatorët që duhet regjistruar 07.
- Konsumatorët që janë të bllobuar 430.
- Konsumatorët që nuk kanë lidhje të ujit 80.
- Rekorde të reja 81.
- Kërkesa nga konsumatorët për bllobim 11.
- Kontroll hidrantave 97.
- Zevendesim 01.
- Regjistrim i ri 02.
- Vend i papërshtatshëm 06.

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	<i>Bllombim-Kontrata</i>	391
2	<i>Ribllombim</i>	275
3	<i>Dera Mbyllur(Heren e dyte)</i>	526
4	<i>Pa ujemates</i>	36
5	<i>Jane te bllombuar</i>	430
6	<i>Nuk kane lidhje uji</i>	80
7	<i>Duhet regjistruar</i>	07
8	<i>Rekorde te reja</i>	81
9	<i>Kerkesa për bllombim</i>	11
10	<i>Kontroll hidrantave</i>	97
11	<i>Zevendesim</i>	01
12	<i>Regjistrim i ri</i>	02
13	<i>Vend i papërshtatshem</i>	06

AKTIVITETET KRYESORE:

- * Vizit dhe kontroll të hidrantave për qytetin e Prizren-it.
- * Vizit kompani "Hidrodrini" rreth funksionimit të programit GIS.
- * Takime në SHUKOS, me grupin PRU të mbajtur në Prishtinë.
- * Pjesmarrje në seminarin për trajtimin e ujërave të zeza e cila u mbajt në Prishtinë, ku në këtë seminar bënë prezentimet e tyre D.T dhe UPZH.
- * Angazhim për marrjen e pelqimit të mbetur nga QRTK-Prizren.
- * Vizit në teren rreth projektit Eficienca e energjisë.
- * Takim në SHUKOS me grupin PRU për ditën botrore të ujit.
- * Trajnimi për menaxhimin e thatësirave (Urim Selimaj, Nëntor Baraliu).
- * Shenimi i ditës boterore të ujit "22 Mars", në Prizren dhe Prishtinë.
- * Takim në kompani për projektin e "Eficiencës së energjisë".
- * Futja e të dhënave në hartat: 7E122011, 7E122018. Kontrolli me data basë i hartës 7F122009 dhe kontrolli detal i hartës me ekipet e terrenit rreth mungesës së shënimeve në hartën 7E122009. Përgaditja detale për printim, vektorizimi i objekteve të reja dhe futja e rekordeve në hartën 7E123011. Refreshimi i hartave: 7F121109, 7E123002, 7E123006 nga terreni, përgaditja dhe printimi i hartave: 7E123005, 7E123009 për teren.
- * Kontrollimi i data basës, printimi i data basës për hartën 7E122009, regjistrimi i hartës 7E122009 në data basë, regjistrimi i rekordeve të reja në hartat: 7E123005, 7E123008, 7E123011.Refreshimi në D.B i hartave: 7E123006, 7E123005, 7E123009, përgaditja e formularit D.B për teren si dhe bashkepunimi me inkasantët.
- * Në muajt Janar-Mars, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kane arritur qe gjithsej të demontojnë dhe montojnë 366 ujëmatësa, ekziston raporti i veçant.
- * Grupi i detektimi të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Janar-Mars,ka bërë gjithësej 135 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 79 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 6,654 m.
- * Leximi i ujëmatësave zonal për muajt Janar-Mars, ujëmatësat në pikat matëse: Jusuf Gervalla, Kobaj, Grazhdanik dhe te FSK-ja kemi lexim të ulët të ujëmatësave (mbetet të verifikohen ujëmatësat), Atmaxh lexim i ulët (bypass). Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt për këta muaj.
- * Po ashtu në muajt Janar-Mars kemi pasur 11 rast për riparimin e ujëmatësave që janë sjellë nga vete konsumatorët, ekziston raporti i veçant.

2.5 Servisimi i ujëmatësave: Janar-Mars, 2016

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipin e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit. Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Njësia Operative	Profili Φ mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	93	-Ndrim i ujëmatësit Zonal $\Phi 150$ „Rezervoari Kobajë“ - Riparimi i ujëmatësit $\Phi 50$ Fakulteti ...
	3/4"	210	
	1"	25	
	5/4"	1	
	6/4"	3	
	Gjithsejt:	332	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Dragash	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Malishevë	1/2"	11	
	3/4"	28	
	1"	4	
	Gjithsejt:	43	

Totali: 375 copa
+ 59 për „Radoniqi“-n
434 copa

-Leximi i ujëmatësave 2 herë në muaj.
-5 Ekspertiza

2.6 ANALIZAT E UJIT TË PIJES - TM1 - 2015

Raporti i aktiviteteve dhe analizat bakteriologjike, Janar-Mars 2016

Shërbimi i përpunimit dhe kontrolli i kualitetit të ujit

Laboratori “Hidroregjioni Jugor”

Vëndi i marrjes së mostrave	Data	Përgjigjet	Nuk përgjigjet
1.Burimi 1, 40 Burime	08.01.		Jo
2.Kaptazha e IV-të,40 Burime	08.01.		Jo
3.Komora mbledhëse, 40 Burime	08.01.		Jo
4.O 700, 40 Burime	08.01.		Jo
5.ShF“Haziz Tolaj”	14.01.	Po	
6.ShF“Abdyl Frashëri”	14.01.	Po	
7.KP“Adem Jashari”	14.01.	Po	
8.KP“Tyrbja”	14.01.	Po	
9.KP“Shadërvan”	19.01.	Po	
10.DPT“Berber”Kurillë	19.01.	Po	
11.6 çeshmet	19.01.	Po	

12.KP"Binbashi"		19.01.	Po	
13.Ëmbëltore"Te Daja"	19.01.		Po	
14.SHFM"Fatmir Berisha" 2x		21.01.	Po	
15.SHFM"Lekë Dukagjini" 2x		21.01.	Po	
16.ShM"Remzi Ademaj"		21.01.	Po	
17.ShF"Migjeni",Gjinoc,Suharekë		27.01.		Jo
18.ShM"Jeta e Re", Suharekë	27.01.		Po	
19.KP"Benafi", Suharekë		27.01.		Jo
20.Xhamia, Banjë, Malishevë		27.01.		Jo
21.ShF"Hamdi Berisha"	27.01.			Jo
22.ShF"Naim Frashëri", Vlashne		29.01.	Po	
23.Kuvendi Komunal,Dragash	29.01.		Po	
24.KFOR-I Turk, Dragash		29.01.	Po	
25.Kafeter.'Dita"Zhur		29.01.	Po	
26.Kabash I H,		03.02.		Jo
27.Kushnin		03.02.	Po	
28.Atmaxh		03.02.	Po	
29.ShF"Luigj Gurakuqi", Nashec	03.02.		Po	
30.Emergjenca, te Viva	10.02.		Po	
31.Univerziteti	10.02.		Po	
32.KP"Tyrbja" te QKMF	10.02.		Po	
33.ShF"Fatmir Berisha"	10.02.		Po	
34.ShF"Abdyl Frashëri" 2x		15.02.	Po	
35.ShF"Haziz Tolaj" 2x	15.02.		Po	
36.QMF-Arbanë 2x		15.02.	Po	
37.QMF" te Tytbja" 2x	15.02.		Po	
38.Koagulatori, Dragash		22.02.		Jo
39.Kfor-I Turk, Dragash	22.02.		Po	
40.Kuvendi Komunal, Dragash	22.02.		Po	
41.Caff."Diti",Zhur		22.02.	Po	
42.KP"Gani Tada"		25.02.	Po	
43.KP te Spitali	25.02.		Po	
44.KP"Binbashi"		25.02.	Po	
45.Gjimnazi"Jeta e Re",Suharekë		29.02.	Po	
46.KP"benaf", Suharekë		29.02.	Po	
47.Gjimnazi"H.berisha", Malishevë		29.02.		Jo
48.Xhamia, Banja e Malishevës	29.02.			Jo
49.ShF"Haziz Tolaj", Arbanë	01.03		Po	
50.QMF- Arbanë		01.03	Po	
51.KP"Tregu I Bylmetit"		01.03.	Po	
52.KP"Qoraga"	01.03.		Po	
53.KP"Shadërvan"		03.03.	Po	
54.KP"Te Spitali Regjional"		03.03.	Po	
55.KP"Binbashi"		03.03.	Po	
56.KP"Gani Tada"		03.03.	Po	
57.Çajtores"Elmedina",Dardani	09.03.		Po	
58.KP"Kurilla"	09.03.		Po	
59.DPT"Shantiri",Bazhdarhane 2x		09.03.	Po	
60.ShM"Lekë Dukagjini" 2x		09.03.	Po	
61.ShF"Abdyl Frashëri"	14.03.		Po	
62.KP"Adem Jashari"	14.03.		Po	

63.KP" Tregu u gjelbërt"	14.03.	Po		
64.QMF" Arbanë"	14.03.	Po		
65.Gjimnazi" Jeta e Re", Suharekë	15.03.	Po		
66.ShT" Skender Luarasi", Suharekë	15.03.			Jo
67.KP" Benaf", Suharekë	15.03.		Jo	
68.KP" Xhamia", Banja e Malishevës	15.03.			Jo
69.Gjimnazi" Hamdi Berisha", malishevë	15.03.		Jo	
70.KP" Gani Tada" 2x	22.03.	Po		
71.KP" Sinan Pasha" Shadërvan	22.03.	Po		
72.KP" Te Spitali" 2x	22.03.	Po		
73.Xhamia Tussus	22.03.	Po		
74.KP" Kurillë" 2x	22.03.	Po		
75.Koagulatori, Dragash	29.03.			Jo
76.KP" KFOR Turk", Dragash	29.03.	Po		
77.KP" Kuvendi Komunal", Dragash	29.03.	Po		
78.Caffe" Diti", Zhur	29.03.	Po		

Aktivite tjera:

- Kontrolli I burimeve të 40 Burimet pas rreshjeve të shiut;
- Pasi që turbiditeti ishte në rritje të gjitha burimet I kemi shkarkuar një nga një si dhe galerinë (tunelin) në dalje te O 700;
- Me Shefkatin Ademi ka vizituar burimet dhe sistemin e pompave, një pjesë, kanë aktivizuar;
- Të nesërmen të gjitha burimet nja nga një janë future në system të furnizimit;
- Montimi I hidroforit te koagulatorët gjegjësisht për nevoja të Laboratorit;
- Pas rreshjeve të mëdhaja në ISHP u dakorduar që të marrim së bashku disa mostra për të dërguar në IKSH-Prishtinë për analizë;
- Vizita në ISHP për të diskutuar rreth analizave;
- Kontrolli I paraklorizimit te 40 Burimet, si preventive për rrjetat prej 40 Burimeve;
- Pranimi I bombolave me klor gaz, 1 t dhe 4 x 150 kg.Më pas është bërë montimi I bombolës 1 t-she;
- Vizita në eraMED - Prishtinë për të marrur reagjentet që kemi porositur më herët;
- Përgaditja e raporteve 3 mujore, TM-4 dhe vjetore për vitin 2015
- Takim pune me përfaqesit e ISHP-Prizren, konkretisht me Dr.Fadil Kryeziu. Diskutuar rreth çështjes së monitorimit si dhe liferimit të analizave me kohë(kopjet e analizave liferohen me shumë vonesë);
- Kontrolli I burimeve në 40 Burime për cilësinë dhe sasinë e ujit, pasi që ka pasur rreshura të shumta;
- Me insistimin tonë kemi bërë Kontrollimin e kloit residual në disa pika në qytet me Kimstin Muhamed Domuzeti, përfaqesues I ISHP-prizren;
- Për shkak të rreshjeve të pandërprera kemi kemi shkarkuar burimin me rramje të lirë në komorën mbleshëse dhe burimin me pompim gjegjësisht burimin e parë nga lartë dhe kjo ka zgjatur derisa nuk është normalizuar gjendja në tërësi (10.02.);
- Përgaditja e dokumentacionit për iniciimin e procesit të furnizimit me material për nevoja të laboratorit dhe nevojave në tërësi për shërbimin tonë. Disa herë kemi vizituar zyrtarin e prokurimit për informata për të finalizuar kërkesën për material dhe procedurat e envojshme;
- Për shkak të rritjes së turbiditetit në komorën mbledhëse kemi bërë shkarkimin e burimit me rramje të lirë që ka zgjatur tërë natën(13.02.);
- Disa herë kemi vizituar stacionin e klorifikimit në Mulli për të koordinuar sasinë e klorit residual në pika të ndryshme të furnizimit;
- Pas ankesës të një konsumatori për kualitetin e ujit (I vie era) në Vlashne kemi kontrolluar disa pika si dhe kemi bërë kontrollin në shkollë. Sipas deklaratave të zyrtarëve në shkollë nuk ka pasur asnjë problem si me furnizim ashtu edhe për kulaitet. Problemi është I izoluar dhe ka të bëjë me instalimet e mbrëndshme;

- Vizita në KRU Prishtinë, ku kemi vizituar laboratorin të sapo formuar. Ku, me çrast kemi diskutuar për procesin e akreditimit. Sipas tyre procesi i akreditimit do të finalizohet mbrënda 2-3 muaji;
- Me kërkesë të L.Paqaeizit dhe L.Sallahut kemi bërë kontrollin e ujit në punimet që punoheshin para Lidhjes së Prizrenit. Kemi konstatuar se uji në fjalë është për nevoja të pijes, 2x;
- kemi vizituar konsumatorin në Arbanë pas ankesës së tij se uji është i turbullt.kemi konstatuar se turbiditeti është i madh. Për këtë kemi njoftuar L.Paqarizin se shkaku i turbiditetit të madh është përzjerja eventuale e ujërave dhe se kontrollin e rrjetave duhet të bëjë ekipi i mirëmbajtjes;
- Furnizimi i rregullt të fshatrve Lubizhda e H., Kabash i H. dhe Kushnin si dhe Zhurin me Hipoklorit Natriumi;
- Pas lajmërimit të zyrtarit në Malishevë se është jashtë funksionit aparati i klorifikimit-dozatori, kemi njoftuar Q.Jonuzin që të bëjë demontimin dhe riparimin e saj;
- Vizita të rregullta në objektet kryesore, Bunari I, 40 Burimet dhe Mulli;
- Përcjellja permanente e kloit residual në pika të ndryshme.
- Kontrollime më të shpeshta në 40 Burime pas rreshjeve të shpeshta që ka ndikuar në rritjen e turbiditetit;
- Kontrollimi i shpeshtë të klorit residual në qytet dhe koordinimi i saj me sasinë e ujit;
- Kthimi i burimit në rrjet pasi që turbiditeti dukshëm është zvogëluar;
- Pranimi i saiasë së klorit gaz, 3 x 150 kg, dhe Hipoklorur Natrimi, 1250 l;
- Montimi i bombolës 1 t-she në stacionin e klorifikimit në Mulli;
- Vizita në EraMed – Prishtinë për pranimin e disa aksesoreve që kemi porositur më parë;
- Kontrolli i rrjetit në Arbanë për prezencën e klorit residual dhe konstatuam se problemi me turbiditet nuk është sanuar në tërësi për ç`gjë ju kemi informuar;
- Kontrolli i ujësjellësave në Has, Kabash ,Lubizhdë dhe Kushnin, si dhe furnizimi i tyre me klor;
- Vizita në Suharekë për të diskutuar çështjen klorifikimit dhe sygjerimet që janë dhënë për të përmirësuar sistemin e klorifikimit në tërësi;
- Për shkak të punimeve që po zhvillohen në instalimin e rrjetit të kanalizimit është dashur që të ndërprejmë procesin e klorifikimit dhe të largojmë nga rrjeti ujin e 40 Burimeve përderisa janë sanuar defektet në rrjetin e ujësjellësit;
- Vizita në ujësjellësin Zhur dhe liferimi i Hipoklorur Natriumit për klorifikim.

Analizat Bakteriologjike ISHP-Prizren

- Prizren – prej 150 analizave, 4 nuk ju kanë përgjigjur (përbëjnë klor residual prej 0.2 – 0.3 mg/l);
- Dragash – prej 8 analize, 1 nuk është përgjigjur;
- Suharekë – prej 16 analizave, 3 nuk i përgjigjen;
- Malishevë – prej 13 analizave, të gjitha i përgjigjen.

Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren Janar-Mars /2016

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	05	05*
	Ujësjellës	150	04
Suharekë	Burim	01	01*
	Ujësjellës	16	03
Dragash	Burim	01	01*
	Ujësjellës	08	01
Malishevë	Burim	02	02*
	Ujësjellës	13	00
Totali		196	08

*analizat e ujit të burimeve nuk mirren në konsideratë. Uji i patrajtuar.

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjellësit është 187 dhe nga këto 8 mostra nuk i përgjigjen.

2.7 Aktivitetet e Ujerave te Zeza – Janar-Mars, 2016

Faza e parë I e projektit

“Ndertimi i Kolektorit Kryesor”

- Të dhënat Teknike

-Gjithsejt gjatësia e kolektorit që do të instalohet është rreth 5100m.

- Diametri i kolektorit fillon nga DN500mm deri në DN1200mm në hymje të ITUZ-se dhe DN 1000mm në dalje të ITUZ-se. Tipi i gypit është HDPE i brinjëzuar SN8 (CL 8kN/m²) dhe Gize K9

- Kolektori do të vendoset në rrugë në anën e djathtë të rrjedhjes së Lumbardhit dhe do të vendoset në vendin e kolektorit të vjetër, ku do të përfshijë këto rrugë: Enver Haradinaj, Remzi Ademaj, pjesërisht Wiliam Wolker, Rruga magjistrale M25 deri tek ITUZ, ndërsa vazhdimi i kolektorit nga rrethi i fshatit Hoqe e Qytetit deri tek kyqëja Jugore e Autostradës do të kalojë në mes të rrugës M25 pastaj nga ky pozicion do të vazhdohet deri tek kyqëja në ITUZ.

Çmimi

-Vlera e punimeve sipas kontratës së nënshkruar në mes të PASSAVNTE dhe KRU“Hidroregjioni Jugor” Sh.A është: 2,043,273.00 Euro.

Afati (data) i fillimit të punimeve

-Sipas planit dinamik të përkthyer në kontratë punimet duhet të fillojnë të Hënë me 15.12.2014 dhe duhet të përfundojnë të Hënë me 12.12.2016, mirpo për shkak të vonësive në rregullimin e pelqimeve dhe lejeve të cilat janë të domosdoshme për fillimin e punimeve kemi pasur ngecje në fillimin e realizimit të punimeve në terren.

-Përfundimisht pas marrjes së të gjitha pelqimeve dhe Lejes nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizem punimet kanë filluar me datë 06.06.2015 pasi që është bërë furnizimi me material konform kontratës.

Progresi i punimeve në Faza e parë I të projektit

Në Pjesën A (Task A) deri më tani janë realizuar hapja e kanalit, vendosja e zhavorit, vendosja e gypave, mbulimi i kanalit të gjitha këto sipas detaleve të dhëna në projekt dhe atë;

Instalimi i Gypave të kolektorit 1265 m.

-Gypi DN800mm HDPE i brinjëzuar SN8 (CL 8kN/m²) L=1215 m,

-Gypi DN1000mm HDPE i brinjëzuar SN8 (CL 8kN/m²) L=1300 m,

Instalimi i pusëve nga P101 deri P151 gjithsej 150 pusëta, si dhe të gjitha pjesët përcjellese.





Kane perfunduar punimet ne ndertim te pusetes shkarkuese (kaperderdhesit) CSO S1 tek rrethi i fshati Hoge e Qytetit, ku ky kaperderdhes eshte ndertuar brenda trupit te rruges M25 dhe njeherit bene lidhjen e kolektorit ekzistues me ate te kolektorit te ri.



Punet ndertimore Task A, CSO 1

Obligimet ndaj kontraktorit

Ne baze kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A eshte realizuar edhe pagesa e avansit me vler 20% te kontrates mjete keto te siguruar nga Qeveria e Republikes se Kosoves permes ministris se linjes MMPH.

Sa i perket furnizimit me material nga kontraktori ne si Hidroregjion kemi bere kerkesat e duhura ne MZHE per mundesine e lirimit nga taksat doganore, i kemi derguar ne MZHE te gjitha dokumentet e nevojshme ne lidhje me mundesine e lirimit nga Taksat doganore per pjesen qe do te financohet nga KfW.

Momentalish kane filluar punimet tek CSOS1g te Marashi dhe kolektori te lokacioni i ETC-se Eshte nenshkruar IPC 1-Fatura e pare per punekryerje te Fazes I nga ana jone dhe eshte derguar tek Passavante, e cila pastaj duhet te dergohet tek KfW pasi qe kjo pagese do te kryhet nga KfW.

Kontigjenti i dyte per Fazen I i furnizimit pas kerkeses sone dhe plotesimit te dokumentacionit perkates ne MZHE, eshte liruar nga TVSH-ja.

Ne muajin Mars kan filluar punimet per ndrrimin e gypit ne rrugen Remzi Ademaj ne jesen prej Komunes deri tek Hotel Theranda, me nje gjatesi preh 475m , deri me tani kemi perfunduar afersisht 30% te ketije segmenti, njekohesisht eshte bere edhe ndrrimi gypit te ujesjellesit ne kete rruge. Eshte instaluar gypi i kanalizimit me je distance prej 30m dhe kycja ne kolektorin e ri.

Punimet jane duke vazhduar ne kete segment dhe shpresojme qe do te perfundojne sipa planit dinamik te paraqitur nga Kontraktori.

Faza e dyte II e projektit:

“Dizajnimi dhe ndertimi i Impiantit per trajtimin e ujerave te zeza”

- Projekti ka të bëjë me dizajnimin dhe ndërtimin e ITUZ-së, për realizimin e këtij projekti me datë: 05.05.2015 është nënshkruar kontrata në mes të kompanisë AQUALIA nga Spanja si dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A, vlera e kontratës është 10,354,512.41 EUR .

Sipas marrëveshjes kontraktuale për këtë projekt duhet të paguhet avanci me vlerë prej 20% e vlerës së kontratës, pagesë të cilën duhet ta paguaj MMPH.

- Deri me tani konform marrëveshjes speciale të reviduar nga ana e kontributit vendor janë paguar në emër të avancit për Fazën II, 625,000.00 Euro kurse pjesa e mbetur duhet paguar nga KfW.

Bazuar në Marrëveshjen e vecantë në të cilën është qartësuar planifikimi i mjeteve për kontributin vendor dhe kontributin e jashtëm, është riplanifikuar buxheti i kontributit vendor ku dhe sipas minutave të takimit të datës 14 Tetor 2015 të nënshkruar nga MMPH, Komuna e Prizrenit, HRJ dhe KfW është parapare:

Kontributi vendor

2014	Euro	FAZA I	99,763.70
2015	Euro	Pjesa e parë e vitit FAZA I	374,275.82
2015	Euro	Pjesa e dytë e vitit FAZA II	625,000.00
2016	Euro		2,500,000.00
2017	Euro		1,400,960.48
			=====
			5,000,000.00EURO

Aktivitetet e ndërtimit Faza 2

Kontraktori ka finalizuar çështjet e mobilizimit dhe ato administrative. Faturat e pagesës së avancit është dorëzuar.

Tani kontraktori është duke punuar në projekt,

- përditësimi i trasesë (layout) së Impjantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në bazë të kërkesave të punëdhënësit,
- përgatitja e orarit të projektimit dhe planit dinamik është në progress,
- kordinimi për zhvendosjen e linjës së rrymës elektrike mbitokësore me KEDS-in,
- kordinimi i pikave kyqëse të furnizimit me rrymë për Impjantin për Trajtimin e Ujërave të Zeza me KEDS-in,
- kontraktori do të angazhojë një kompani për të bërë matjet gjeodezike.

Periudha e projektimit është 120 ditë. Për të shmangur vonesat për shkak të dokumenteve jo të kënaqshme të projektit, është pajtuar që të dorëzohen projektet në pako.

Pakoja e parë – Projekti Konceptual i Azhurnuar u dorëzua me 24 Korrik

- Që përbëhet nga një vizatim i trasesë (layout), P&ID, profil hidraulik.

Pakoja e dytë – Projekti Kryesor pritet me datën 30 Shtator

- Vizatimet që kërkohen për marrjen e lejes për projektet e kategorisë III, p.sh. projektet civile për të gjitha strukturat dhe njësitë, të gjitha vizatimet layout (të përgjithshme, gypat, rryma, rrugët, hapësira, etj), vizatimet e azhurnuara të projektit konceptual. Ku kjo pako është prezantuar në takim të fundit të mbajtur në HRJ në fillim të muajit Nentor 2015

Pakoja e tretë – Projekti i Detajuar pritet të jetë pjesërisht krahas me progresin në ndërtim.

- Vizatimet detale që kërkohen për ndërtimin e secilës njësi/ndërtesë/strukturë, duke përfshirë kalkulimet statilke, lista e paisjeve etj. (krahas progresit të projektit).

-Në takimin e fundit gjatë muajit tetor kemi patur një takim me kontraktorin e Fazës II dhe Konsulencën ku dhe kemi diskutuar në lidhje me shtrirëjen-situacionin e brendshëm të impiantit, që nënkutpon metodën e trajtimit, shtrirëjen e objekteve administrative dhe percjellese, dhe pritet miratimi nga ana e HRJ-se.

-Punëdhënësi HRJ ka shprehur gadishmërinë për t'i asistuar Kontraktorit në të gjitha çështjet për të marrë lejet e kërkuara. Ligjet relevante dhe udhëzimet administrative iu janë dhënë Kontraktorit.



Pamja e ITUZ-se ne 3D

-Per shkak te pengesave nga pronaret e shpronësuar nuk ka aktivitete të ndërtimit deri më tani

-Ne se bashku me konsulencen dhe kontaktorin ne nje takimi ne zyren e DSHP-se dhe permes nje shkrese elektronike e kem njoftuar DSHP ne komunën e Prizrenit, per pengeset qe i kemi nga pronaret e shpronësuar te lokacionit ku do te ndertohet ITUZ dhe kemi kerkuar nga DSHP si bartese e projektit per shpronësimit qe te ndermarre masat e duhura qe mos te ngecim me projektin ne fjale pasi qe cdo vonese do te reflektoje ne kosoton e projektit si dhe do te rrezikoj investimin ne pergjithesi.

-Pas bisides telefonike qe kam pas me zyrtarin komunal ne zyren e pronave ne komunën e Prizrenit, z. Gursel Skenderi, me eshte thene se pa u paguar edhe centi i fundit tek [ronaret ne nuk kemi te drejte qe pronat e tyre ti bartim tek Komuna.

-Sa i perket lejes se ndertimit te cilen duhat ta kerkojme tek Departamenti i ndertimit ne MMPH, paraprakisht duhet nxjerre dokumenti i VNM-se , i cili po ashtu kerkon kriterin kryesor shpronësimit perfundimyatre te lokacionit, prandaj ne rast se kemi pengesa ne pagesen e pronarve, komuna e prizrenit duhet te krijojë nje KONTO MIREBESIMI ne te cilen duhet te derdhe te gjitha mjetet e parapare per shpronësimit dhe ne momentin qe do ta kemi kete dokkument do te fillohet me perpilimin e VNM-se si kusht kryesor per posedimin e lejes se ndertimit nga MMPH.

Perpos takimeve per mbarevajtje te punimeve nuk kemi patur ndonje progres te theksuar ne lidhje me Projektin ne fjale,

Pas takimit me Drejtorin e sherbimeve publike ne nje konference i njeiti gojarisht me tha qe sa i perket kontos se mirebesimit ajo do te nxjerret nga komuna vitin e ardhshem ne fillim te 2016-tes.

Per momentin jemi ne pritje te kthimit te pronave ne emer te Komunes ne menyre qe te munde te procedojme me lejen e ndertimit ne MMPH, dokumernt ky qe do te na lejoje casjen ne lokacionin e ITUZ-se.

Aktivitetet mujore Janar-Mars, 2016 – Njesia Prizren

Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, përveq në disa raste kur ka pasë ndonjë ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjet të ujësjesit dhe gjatë punimeve për pastrimin e ujëmatësave si dhe me rastin e vershimeve me datë: 06.01.2016, ku ka ardhur deri te ndotja e ujit dhe jemi obliguar me ndërpre furnizimin për qytetin e Prizrenit, poashtu në rrugen Remzi Ademaj ku janë duke u kryer punimet dhe gjatë punimeve ka pas nderprerje te kohëpaskohshme deri në 10 ore.

Prodhimi i ujit: në TM-1 janë prodhuar **3,108,200.00 m³** ujë ose **395.3 l/s** dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët përveq në lagjet me sistem pompimi Bazhderhanen, Dardanin dhe pjesën e eperme të Tusuzit.

Humbjet e ujit: humbjet e ujit arrijnë në **58.12 %** për shkak të rrjetit të vjetër të ujësjellësit dhe ndërhyrjeve të pa legalizuara.

Operacionët e mirëmbajtjes së ujësjellësit dhe kanalizimit:

Gjatë muajit Janar furnizimi me ujë ka qenë i rregullt 24 orë në zonat e ulta dhe me reduktime në lagjet Dardania, Bazhderhane dhe Tusuz.

Aktivitetet mujore janë paraqit në menyre tabelare.

Gjatë muajve Janar-Mars janë shqyrtuar gjithsejt **572** ankesa dhe të gjitha kanë përfunduar me eliminimin e defekteve të ndryshme.

Në rrjetin e ujësjellësit janë bërë **403** aktivitete, ndërsa në rrjetin e kanalizimit **169** raste.

Gjithsej aktivitete në ujësjellës Janar-Mars			
1	Defektet ne rrjetin sekundar	186	defekte
2	Defektet ne rrjetin primar	28	defekte
3	Defekte ne komplet rrjetin	214	defekte
4	Bartja e ujit me cistern	8	m ³
5	Pastrimi dhe fryerja me kompresor	17	raste
6	Rregullimi i rruges	39	m ²

Gjithsej aktivitete në kanalizim Janar-Mars			
1	Kontroll i pusetes	204	copë
2	Pastrim i pusetes	141	copë
3	Kontroll i kanalizimi	7248	metra
4	Pastrim i kanalizimi	4228	metra
5	Ndërrim i pusetes	1	copë
6	Ndërrim i kanalizimi	16	metra
7	Riparim i rrugës	24	m ²

Trajtimi dhe klorifikimi:

Këto veprime bëhen pa ndërprerje dhe analizat e ujit nga Enti Higjenik Regjional janë në baz të raporteve mujore.

Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit

- Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në Qytet dhe regjion (fshatra dhe sipas nevojës edhe në njësit tjera si Suharekë, Malishevë e Dragash).
- Marja e mostrave në Qytet, Njësi (si „Hidroregjion Jugor”) dhe në Fshatra të cilat menagjohen nga ana jonë dhe punimi i tyre në laboartorin tonë.
- standardeve të ujit të pijes. Mostrat janë marrun si vijonë:
- Marrja e mostrave **Fiziko-Kimike**
- Marrja e mostrave **Bakteriologjike**

Aktivitetet mujore Janar-Mars, 2016 - Njesia Suharekë

* *Furnizimi me ujë, Janar-Mars - 2016* – ka qenë i rregullt dhe pa ndërprerje, në përjashtim të disa ditëve kur ka patur ndërprerje të energjisë elektrike të Pusi i Atit (Malsi e Re), të njoftuar nga ana e operatorit elektrik KEDS-i* *Analizat e ujit- Janar-Mars - 2016* - janë bërë 16 mostra të ujit të pijes nga Institutit i Shëndetit Publik, 13 prej të cilave i përgjigjen standardeve dhe 3 nuk i përgjigjet standardeve (ISHP).

* *Rregullimi i defekteve - Janar-Mars - 2016* - janë riparuar gjithsejtë 73 defekte në rrjetin e ujësjellësit dhe 35 deblokime të kanalizimeve, si dhe janë rregulluar 85 m² kubëza në lokacionet ku më parë është intervenuar në sanimin e defekteve.

* *Leximi i ujëmatësve* - është bërë leximi i çdo ujëmatësit dhe verifikimi i gjendjes së pusetave, në fshatin Mushtisht. Nga ky aktivitet është bërë një raport i cili u është adresuar menaxherit të njësisë së Suharekës. Në këtë aktivitet ka marr pjesë 1 punëtorë nga operativa, inkasanti përgjegjës dhe një përgjegjës i operativës.

* *Vendosja e ujëmatësve në institucionet Publike* - janë vendosur ujëmatësit në këto institucione : Parku i Qytetit – Suharekë, Zyrja e Vendit – Studenqan, Stadioni i Qytetit – Suharekë, Fabrika “Arta Tex “ – Mushtisht.

* *Detektimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Reshtan* - gjatë detektimit të rrjetit të fshatin në fjalë, janë vërejtur 3 defekte në gypa sekondar të ujësjellësit, të cilat më pas nga ekipi i mirëmbajtjes janë rregulluar.

* *Pastrimi i Rezervuarëve dhe hapësirave për rreth* - është bërë pastrimi i hapësirës së rezervuarit kryesorë të qytetit të Suharekës, në Shirokë, në Mushtisht si dhe në rezervuarin e fshatit Reshtan është bërë pastrimi i hapësirës rreth rezervuarit si dhe brenda tij.

* *Hapja e kanalit* - në fshatin Studenqan është bërë hapja e kanalit me gjatësi L= 50m , pasi që gypi ekzistues ka penguar konsumatorin pasi që e ka bërë nivelimin e oborrit.

Aktivitetet mujore Janar-Mars, 2016 – Njesia Malishevë

* *Furnizimi me ujë, Janar-Mars - 2016* - ka qenë i mirë dhe pa reduktime.

* *Analizat e ujit – Janar-Mars - 2016* - janë realizuar 13 mostra të analizave bakteriologjike dhe 13 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

* *Aktivitetet lobimi* - kontakte të rregullta me perfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, atë të Urbanizimit si dhe me Drejtorin e Financave, Kontakte me zyrtaret e KEDS-it për montimin e rrjetit elektrik në fsh. Senik deri te stacioni i pompave, ku gjatë këtij muaji është realizuar montimi i lartperqutit si dhe montimi i Transformatorit në këto lokacione

* *Rregullimi i defekteve – Janar-Mars / 2016*: Rrjeti primar 29 defekte, rrjeti sekondar 54 defekte, deblokimi i kanalizimeve 12 ndërhyrje dhe 2.0 km kanal të pastruar, ankesat teknike 15, ankesat komerciale 15, njoftime për shkyqje 194, kyqje të reja 102, amvisëri 97, lokale – 5, procesverbale të shkyqjeve 39, verifikim të ujëmatësve 421, ujëmatës të ndërruar 65, ujëmatës të montuar 57.

Aktivitetet mujore Janar-Mars, 2016 - Njesia Dragash

* *Furnizimi me ujë* ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këtij muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh.

* *Trajtimi i ujit (sendimentimi, kaugulimi, filtrimi dhe klorizimi)* është bërë në vazhdimsi.

* *Aktivitetet nga ekipi teknik në operativë* janë bërë këto: 15 raste sanim në rrjetin e ujësjellësit, 12 ndrrime të ujëmatësve, 33 pastrim dhe kontrole të ujëmatësve, 4 montim i ujëmatësve të ri, 1 kyqje në rrjetin e ujësjellësit, 15 raste të pastrimit të pusetave, 140 m deblokime dhe pastrime në rrjetin e kanalizimit, 14 angazhime tjera të ekipit teknik.

* *Punët në administratë* janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon kompania duke i përfshirë punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratës së përgjithëshme.

* *Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimt në Dragash, në fshatin Pllavë, në fshatin Shajne dhe Brezne.*

* *Prodhimi i ujit: Janar-Mars* janë prodhuar 69,300.00 m³ ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

* *Humbjet e ujit: Janar-Mars* arrijnë rreth 50.20 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësit.

III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË

3.1 Aktivitetet

Është bërë leximi i ujëmatësve nga Inkasantët (lexuesit) e terrenit .
Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
Janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit .
Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike dhe komerciale të konsumatorëve

Janë shpërnda njoftime për mospagesë të shërbimeve të ujësjellsit te konsumatorët të cilët nuk paguajn faturat dhe atyre që kanë borxhe të të mëdha ndaj KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha.
Ka vazhdu aktiviteti për shqyrtim të kërkesave për faljen e borxheve, ku mund ta gjeni raportin

Falja e Borxheve 01.10.2015- 31.03.2016

Njesia	Nr. Konsumatoreve	Nr. Kontratave	Shuma Kontraktuar	Shuma Inkasuar	Shuma Falur
DRAGASH	148	148	10,630.98	5,709.90	37,077.65
MALISHEV	123	126	26,682.35	5,293.57	15,313.29
PRIZREN	1885	1854	49,577.71	153,043.01	411,522.96
SUHAREK	119	123	18,174.66	5,445.15	23,542.70
Total	2,275	2,251	105,065.70	169,491.63	487,456.60

Janë bërë kontrolle në teren te konsumatorët nga ekipet e kontrollës për mospagesë të borxheve, lidhje jashtë ujëmatësit dhe regjistrime të konsumatorëve të rinj.

3.2 Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkyçjes TM1-2015- TM1- 2016

TM1- 2015

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Shkyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi nga Kontro.
1	Prizren	221	4	2	1837	37,328.72
2	Suharekë	14	5	2	670	3,219.00
3	Malishevë	147	33	10	840	7,731.76
4	Dragash	0	0	0	0	0.00
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	382	42	14	3347	48,279.48 €

- Gjate TM1 2016 janë pranuar 468 ankesa në total, prej tyre 306 ankesa teknike (+ 150) dhe 162 ankesa komerciale. (+ 15), Të gjitha ankesat janë shqyrtuar në pajtim me procedurat e mbrendshme te Kompanisë, te ankesat komerciale konsumatorët kanë marr përgjigje me shkrim nga komisioni i cili ka shqyrtuar këto ankesa.

TM1- 2016- Ankesat teknike dhe komerciale

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	306
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	306
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	162
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	162
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	162
Total		468

TM1- 2015- Ankesat

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	156
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	156
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	147
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	147
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	147
Total		304

3.3 PROBLEMET QË KANE NDIKUAR NE MOSARRITJEN E CAQEVE

Mos zgjidhja e problemit të rasteve sociale , kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit te kjo kategori e konsumatorëve.

Pamundësia e leximit të ujëmatsve për çdo muaj te një numër i konsumatorëve, nga inkasantët tek shtëpit (pronat) e konsumatorëve, pasi në kohën kur bëhet leximi nuk gjenden në shtëpi apo edhe nuk i hapin dyert për tui mundësuar inkasantëve leximin e orëve (kryesisht te konsumatorët që jetojn në ndërtesa kolektive-banesa).

Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kan qenë nën administrimin e Agjensionit Kosovar të Pronës.

Borxhet e ndërmarrjeve të Privatizuara, të cilat refuzohen si borxhe nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit. Borxhet të cilat janë pranuar , ende nuk është bërë pagesa e tyre pasi që pritet procesi i Likuidimit të këtyre ndërmarrjeve.

3.4 MASAT E REALIZUARA/ MOSREALIZUARA NGA TREMUJORI PARAPRAK

Rritje të numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit si rezultat i legalizimit të konsumatorëve ilegal apo edhe pëlqimeve për kyqje.

Kemi një rritje të ujit të faturuar në krahasim me vitin paraprak si rezultat i rritjes së numritkonsumatorëve në zonën e shërbimit
Rënie e inkasimit gjatë muajit janar si rezultat i rënies së pagesave nga konsumatorët

3.5 MASAT E PROPOZUARA PËR MUAJT E ARDHSHËM

Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në faljen e borxheve

Vazhdimësia e mbështetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat

Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasntëve në arritjen e limitive në inkasim

Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit

3.6. RAPORT I MEDIAVE

JANAR

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	06.01.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: RESHJET E SHIUT NDIKOJNË NË TURBULLIMIN E UJIT
2	06.01.2016	RTV-BESA	ARTIKULLI: NJOFTIM PËR KONSUMATORË LIDHUR ME NDOTJEN UJIT TË PIJES
3	06.01.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: NDOTET UJI I PIJES NGA TË RESHURAT E FUNDIT NË PRIZREN, HIDROREGJIONI MERR MASA PËR EVITIMIN E GJENDJES
4	06.01.2016	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: NDËRPRERJE TË UJIT TË PIJES PËR SHKAK TË RESHJEVE TË SHIUT
5	06.01.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: NDOTET UJI I PIJSHËM NË PRIZREN
6	06.01.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: VËRSHIMET NDIKOJNË NË REDUKTIMET E UJIT TË PIJES
7	06.01.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI: VËRSHIMET NDIKOJNË NË REDUKTIMET E UJIT TË PIJES
8	07.01.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM PËR KONSUMATORË LIDHUR ME TURBULLIMIN E UJIT TË PIJES
9	07.01.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA MALISHEVË, NDËRPRERJE E FURNIZIMIT PËR SHKAK TË TURBULLIMIT TË UJIT
10	07.01.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA SUHAREKË, NDËRPRERJE E FURNIZIMIT PËR SHKAK TË TURBULLIMIT TË UJIT
11	07.01.2016	www.tv-opinion/facebook.com	ARTIKULLI: KRU- HIDROREGJIONI JUGOR-NJËSIA MALISHEVË, NJOFTON KONSUMATORËT PËR NDËRPRERJE TË UJIT PËR SHKAK TË TURBULLIMIT TË UJIT
12	07.01.2016	www.tv-opinion/facebook.com	ARTIKULLI: KRU- HIDROREGJIONI JUGOR-NJËSIA SUHAREKË, NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJES PËR SHKAK TË TURBULLIMIT TË UJIT
13	07.01.2016	www.tv-opinion/facebook.com	ARTIKULLI: KRU-HIDROREGJIONI JUGOR- NJOFTON KONSUMATORËT SE DO TË FILLOJË FURNIZIMIN ME UJË

14	07.01.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: FILLON FURNIZIMI ME UJË NË QYTETIN E PRIZRENIT, UJI LEJOHET PËR PËRDORIM SANITAR DHE HIGJENIK
15	07.01.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: UJI NË PRIZREN TË VLOHET PARA SE TË PIHET
16	07.01.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI: HIDROREGJIONI JUGOR APELON TEK QYTETARËT: UJI I PIJES DUHET TË VLOHET
17	08.01.2016	THERANDA POST	ARTIKULLI: APELOHET TEK QYTETARËT TË KENË KUJDES ME UJIN E PIJSHËM
18	08.01.2016	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: VËRSHIMET LËNË PASOJA
19	08.01.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: PRIZRENI DHE MALISHEVA ME UJË JO TË PIJSHËM
20	09.01.2016	RTK	PRONONCIM RRETH REZERVUARIT NË KALA
21	09.01.2016	RTV-BESA	PRONONCIM: TURBULENCAT KANË KALUAR, POR PËR SIGURI ËSHTË MIRË QË UJI TË VLOHET
22	09.01.2016	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: UJI NË MALISHEVË TË VLOHET PARA SE TË PIHET
23	14.01.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT PËR SHKAK TË DEFEKTIT
24	14.01.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: DEFEKT NË GYPIN E UJËSJELLËSIT, DISA LAGJE TË PRIZRENIT JASHTË FURNIZIMIT ME UJË
25	14.01.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: DEFEKT NË GYPIN E UJËSJELLËSIT, DISA LAGJE TË QYTETIT PA UJË TË PIJES
26	14.01.2016	www.rtvbesa.facebook.com	AARTIKULLI: DEFEKT NË GYPIN E UJËSJELLËSIT, DISA LAGJE TË QYTETIT JASHTË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJES
27	15.01.2016	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: PUNIMET LËNË PA UJË DISA LAGJE TË PRIZRENIT

SHKURT

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	05.02.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA LAGJE TË PRIZRENIT, PËR SHKAK TË DEFEKTIT
2	05.02.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: SHPËRTHEN UJI TEK RRUGA NË AFËRSI TË URËS SË MARASHIT
3	05.02.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: SI PASOJË E DËMTIMIT TË GYPIT, SHUMË LAGJE DHE KFOR-I NË PRIZREN, NUK FURNIZOHEN ME UJË
4	05.02.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: SHPËRTHEN GYPI I UJIT TEK URA E MARASHIT, VËRSHOHET RRUGA

5	05.02.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: LAGJJA "RALIN", PRIZREN. SOT PARADITE NJË PJESË E QYTETIT MBETI PA FURNIZIM ME UJË PAS SHPËRTHIMIT TË GYPIT TË UJIT GJATË PUNIMEVE
6	09.02.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA TË PRIZRENIT, PËR SHKAK TË MUNGESËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE
7	09.02.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONI", RIKTHEN FURNIZIMIN ME UJË NË DISA LAGJE TË PRIZRENIT
8	09.02.2016	TELEVIZIONI OPINION	EMISION I DREJTPËRDREJT
9	09.02.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: NESËR DO TË KETË REDUKTIME TË UJIT NË DISA FSHATRA TË PRIZRENIT
10	09.02.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONI JUGOR", NJOFTON SE NESËR DO TË KETË REDUKTIME TË UJIT NË DISA FSHATRA TË PRIZRENIT
11	09.02.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: JA CILAT FSHATRA TË PRIZRENIT, NESËR NUK DO TË KENË UJË
12	09.02.2016	www.televizioniprizrenit.facebook.com	ARTIKULLI: NESËR SHUMË FSHATRA TË PRIZRENIT NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË, SHKAK PUNIMET E RIPARIMIT TË RRJETIT NGA KEDS
13	13.02.2016	TELEVIZIONI BESA	PRONONCIM PËR MUNGESË TË UJIT NË RRUGËN "REFKI SHALA", NË LAGJEN KURILLË
14	13.02.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI: BANORËT E RRUGËS "REFKI SHALA" NË LAGJEN KURILLË, ANKOHEN PËR MUNGESË TË UJIT TË PIJES, KRYESHEFI I HIDROREGJIONI JUGOR, POHON SE POMPA NË ATË LAGJE, NUK ËSHTË ASET I YNI
15	23.02.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA LAGJE TË PRIZRENIT, PËR SHKAK TË DEFEKTIT
16	23.02.2016	www.televizioniopinion.com	ARTIKULLI: PESË LAGJE NË PRIZREN, PA UJË
17	23.02.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: SËRISH DËMTOHET NJË GYP TEK "URA E MARASHIT", SHUMË LAGJE TË PRIZRENIT NUK PO FURNIZOHEN ME UJË
18	23.02.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: PESË LAGJE NË PRIZREN, PA UJË
19	23.02.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: PUNIMET NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT LËNË PA UJË DISA LAGJE TË PRIZRENIT
20	23.02.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI: PUNIMET NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT LËNË PA UJË DISA LAGJE TË PRIZRENIT
21	23.02.2016	www.tvopinion/facebook.com	ARTIKULLI: PESË LAGJE TË PRIZRENIT, KANË MBETUR PA UJË
22	24.02.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA TË PRIZRENIT, PËR SHKAK TË

			PUNIMEVE QË ZHVILLON KEDS-i
23	24.02.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË FSHATIN SERBICË E ULTË, PËR SHKAK TË PUNIMEVE QË ZHVILLON KEDS-i
24	24.02.2016	www.televizioniopinion.com	ARTIKULLI: PESË LAGJE NË PRIZREN, PA UJË
25	24.02.2016	www.televizioniopinion/facebook.com	ARTIKULLI: JA CILAT FSHATRA TË PRIZRENIT, DO TË MBESIN PA UJË TË PIJES
26	24.02.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: NESËR SËRBICA E ULTË DO TË KETË REDUKTIM TË UJIT TË PIJES PËR SHKAK TË PUNIMEVE NGA KEDS-i
27	24.02.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: SËRBICA E ULTË, NESËR DY ORË NUK DO TË FURNIZOHET ME UJË
28	24.02.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI: NESËR SËRBICA E ULTË DO TË KETË REDUKTIM TË UJIT
29	24.02.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: EDHE REGJIONI I HASIT NESËR NUK DO TË FURNIZOHET ME UJË
30	24.02.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: DEFEKTI I SHKAKTUAR NGA PUNIMET, LË PA UJË DISA LAGJE TË PRIZRENIT
31	25.02.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA LAGJE TË PRIZRENIT, PËR SHKAK TË DEFEKTIT
32	25.02.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: DËMTOHET GYPI TRANSPORTUES, DISA LAGJE TË PRIZRENIT JASHTË FURNIZIMIT ME UJË
33	25.02.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI: DËMTOHET GYPI TRANSPORTUES, DISA LAGJE TË PRIZRENIT JASHTË FURNIZIMIT ME UJË
34	25.02.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: DËMTOHET GYPI TRANSPORTUES, SËRISH SHUMË LAGJE TË PRIZRENIT JASHTË FURNIZIMIT ME UJË
35	25.02.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: HASI DHE SËRBICA E ULTË, SOT PA UJË
36	25.02.2016	www.tvopinion/facebook.com	ARTIKULLI: DËMTOHET GYPI TRANSPORTUES, DISA LAGJE TË PRIZRENIT JASHTË FURNIZIMIT ME UJË
37	29.02.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM-NJËSIA SUHAREKË- NDËRPRERJE E FURNIZIMIT NË DISA FSHATRA, PËR SHKAK TË PUNIMEVE NGA KEDS-i
38	29.02.2016	TELEVIZIONI PRIZRENIT	ARTIKULLI: 4 FSHATRA TË SUHAREKËS NESËR GJATË DITËS PËR 3 ORË NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
39	29.02.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: KATËR FSHATRA TË SUHAREKËS, NESËR GJATË DITËS, PËR 3 ORË NUK DO TË KENË UJË TË PIJES

40	29.02.2016	www.rtvbesa.facebook.com	KATËR FSHATRA TË SUHAREKËS, NESËR GJATË DITËS, PËR 3 ORË PA UJË
41	29.02.2016	www.televizioniopinion.com	ARTIKULLI: KATËR FSHATRA TË SUHAREKËS, NESËR GJATË DITËS, PËR 3 ORË NUK DO TË KENË UJË TË PIJES

MARS

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI
1	02.03.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË RAJONIN E HASIT,PËR SHKAK TË PUNIMEVE TË KEDS-it
2	02.03.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA TË SUHAREKËS,
3	02.03.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI:DISA FSHATRA TË SUHAREKËS DHE HASIT, NESËR DO TË KENË NDËRPRERJE TË UJIT
4	02.03.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI:DISA FSHATRA TË SUHAREKËS DHE HASIT, NESËR DO TË KENË NDËRPRERJE TË UJIT TË PIJES PËR 3 ORË (VIDEO)
5	02.03.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: ZONA E HASIT NESËR NUK FURNIZOHET ME UJË
6	02.03.2016	TelevizioniOpinion/facebook.com	ARTIKULLI: KEDS-i LË PA UJË DISA FSHATRA
7	02.03.2016	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: HASI NESËR PA UJË
8	02.03.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: HASI NESËR PA UJË
9	03.03.2016	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: PROKURORIA E PRIZRENIT AKTAKUZË KUNDËR 4 PERSONAVE, PËRVETËSUAN MBI 20 MIJË EURO
10	04.03.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: ISH-PUNONJËSIT E KOMPANISË SË UJËSJELLËSIT AKUZOHEN PËR PËRVETËSIM NË DETYRË
11	09.03.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: INSTITUCIONET REKOMANDOJNË VLIMIN E UJIT TË PIJSHËM
12	10.03.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË FSHATIN SALLAGRAZHDË, PËR SHKAK TË PUNIMEVE TË KEDS-it
13	10.03.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: NESËR NË SALLAGRAZHDË DO TË KETË NDËRPRERJE TË UJIT TË PIJES

14	10.03.2016	www.rtvbesa.facebook.com	HIDROREGJIONI JUGOR NJOFTON SE NESËR NË SALLAGRAZHDË DO TË KETË NDËRPRERJE TË UJIT TË PIJES
15	14.03.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA TË HASIT
16	14.03.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: TRE FSHATRA TË HASIT, NESËR PA UJË
17	14.03.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: 3 FSHATRA TË HASIT NESËR NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
18	14.03.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: HIDROREGJIONI JUGOR NJOFTON SE 3 FSHATRA TË HASIT NESËR NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
19	15.03.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË PJSËN QENDRORE TË PRIZRENIT, SI REZULTAT I PUNIMEVE NË GYPIN FI 600
20	15.03.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: PJESA QENDRORE E PRIZRENIT, NUK PO FURNIZOHET ME UJË
21	21.03.2016	RTVBESA	PRONONCIM RRETH PUNIMEVE NË Rr. "WILLIAM WALKER"
22	21.03.2016	www.rtvbesa.facebook.com	ARTIKULLI: SË SHPEJTI PËRFUNDOJNË PUNIMET NË Rr. "WILLIAM WALKER"
23	21.03.2016	KOHA DITORE	ARTIKULLI: POLICIA KËRKON NJOFTIME PARAPRAKE PËR INVESTIMET NË INFRASTRUKTURË
24	22.03.2016	RTVBESA	EMISION: MYSAFIR NË STUDIO - DITA BOTËRORE E UJIT
25	22.03.2016	TELEVIZIONI OPINION	PRONONCIM: DITA BOTËRORE E UJIT
26	22.03.2016	TELEVIZIONI OPINION	PREZANTIM NË SHKOLLËN "ABDYL FRASHËRI"
27	22.03.2016	TelevizioniOpinion/facebook.com	LIGJËRATË E MBAJTUR NË SHKOLLËN ABDYL FRASHËRI ME TEMËN "UJI DHE PUNA"
28	23.02.2016	TelevizioniOpinion/facebook.com	EMISIONI KONTAKT - INTEGRIMI I ZONAVE RURALE NË MENAXHIM TË KRU"HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A.
29	23.02.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: "HIDROREGJIONI JUGOR" DO TË JETË E PËRKUSHTUAR PËR SHËRBIMET E QYTETARËVE
30	24.03.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA LAGJE, PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË GYPIN FI 400
31	24.03.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: DËMTOHET NJË GYP TRANSPORTUES I UJIT, NESËR NUK DO TË KENË UJË DISA LAGJE DHE RRUGË TË PRIZRENIT
32	24.03.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: DËMTOHET NJË GYP TRANSPORTUES I UJIT, NESËR NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË DISA LAGJE DHE RRUGË TË PRIZRENIT
33	24.03.2016	TelevizioniOpinion/facebook.com	ARTIKULLI: KRU"HIDROREGJIONI JUGOR" NË PRIZREN, NJOFTON SE NESËR NUK DO TË KETË UJË NË DISA PJSË TË QYTETIT
34	24.03.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: JA CILAT LAGJE NUK DO TË KENË UJË NESËR NË PRIZREN

35	25.03.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	KONFERENCË PËR MEDIA - MANIFESTIM I DITËS BOTËRORE TË UJIT
36	25.03.2016	Televizioni Prizrenit	(VIDEO) - ME AKTIVITETE TË NDRYSHME, KRU"HIDROREGJIONI JUGOR" SHËNOI DITËN BOTËRORE TË UJIT
37	25.03.2016	TelevizioniOpinion/facebook.com	(VIDEO) - ME QËLLIM TË VETËDIJËSIMIT TË QYTETARËVE PRIZRENAS, RRETH RËNDËSISË SË UJIT, "HIDROREGJIONI JUGOR" PRIZREN, GJATË TËRË DITËS KA ORGANIZUAR AKTIVITETE TË NDRYSHME
38	30.03.2016	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA LAGJE, PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË GYPIN FI 300
39	30.03.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: 4 LAGJE TË PRIZRENIT, AKTUALISHT NUK PO FURNIZOHEN ME UJË
40	30.03.2016	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: KATËR LAGJE TË PRIZRENIT NUK KANË UJË
41	30.03.2016	www.rtvbesa.com	ARTIKULLI: INTERVENIMET NË GYPIN KRYESOR, LËNË PA UJË DISA LAGJE TË PRIZRENIT
42	30.03.2016	www.rtvbesa.facebook.com	(VIDEO) - INTERVENIMET NË GYPIN KRYESOR, LËNË PA UJË DISA LAGJE TË PRIZRENIT
43	30.03.2016	Televizioni Prizrenit	ARTIKULLI: NUK MUND TË EVITOHET DEFEKTI NË TËRËSI EDHE NESËR GJATË DITËS BAZHDARHANJA,DARDANIA, KURILLA DHE 2 KORRIKU, NUK DO TË FURNIZOHEN ME UJË
44	30.03.2016	www.tv-opinion.com	ARTIKULLI: KATËR LAGJE TË PRIZRENIT NUK KANË UJË

IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

4.1.1 Aktivitetet Janar-Mars 2016

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marrë me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Kompanisë, Komisioni i Auditimit, Komiteti i Financave, Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji, Komiteti për Staf dhe Shpërblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë përgatitur dhe vazhduar kontratat e punës për vitin 2016, për të gjithë punëtorët e Kompanisë. Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në Raportin e vlerësimit vjetor të punës nga Mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të secilit punonjës. Kontratat e Punës janë vazhduar për kohë të caktuar dhe për kohë të pacaktuar, kjo duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës nga Mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të secilit punonjës.
- Shërbimi juridik ka përgatitur Kontratat në mes të Kompanisë dhe palëve të treta nga lëmia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim për të punësuarit e Kompanisë i ka lëshuar të gjitha llojet e Aktvendimeve, Autorizimeve dhe Vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës sipas kërkesave të punëtorëve.
- Në pajtim me Ligjin e Punës për punëtorët të cilët kanë punuar jashtë orarit të punës janë lëshuar Aktvendime lidhur me kompensimin e punës jashtë orarit.
- Është përgatitur Libri lidhës për Qeverisjen Korporative për vitin 2015 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë : Certifikatën e regjistrimit të Biznesit, Vendimin mbi emërimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për vitin 2015, Vendimet e Bordit për 2014, Procesverbalet e Komisionit të Auditimit, Deklarata e politikës së kompensimit, Vendimet mbi themelimin e komiteteve tjera të Bordit, Procesverbalet e komiteteve, Plan-Biznesi 2014-2016 (2015-2017) dhe raporti vjetor 2015.
- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista e pagave të Zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve të tjerë - Kategoria e Parë për Dhjetor 2014.
- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista me numrin e të punësuarve dhjetor 2014 dhe numrin e të punësuarve të rinj gjatë vitit 2014.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Universitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit dhe financave. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikëqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- **Aktivitetet gjatë muajit Janar 2016**
- Sipas kërkesave të parashtruara janë marrë në punë 3 (tre) punëtorë me Kontratë për punë dhe detyra specifike.
- Janë finalizuar kontratat e punëtorëve për vitin 2016.
- Ne Zyrën ligjore është pranuar një praktikante për tre muaj.
- Ka pas pushime vjetore si kompensim për punën jashtë orarit për dy punëtorë.
- Gjatë muajit Janar janë shpallur **4 (katër)** Konkurse.
- Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesës së U.D. të Sekretarit të Kompanisë.
- **Aktivitete gjatë muajit Shkurt 2016**
- Sipas Kërkesës së parashtruar është pranuar në punë një punëtorë me Kontratë për punë dhe detyra specifike.
- Një punëtorë e ka sjell Diplomën e Bachelor-it.
- 2 (dy) punëtorë kanë marrë pushim si zëvendësim për punën e kryer jashtë orarit.

- Gjatë këtij muaji dy punëtorë kanë bërë Kërkesë për pushim pa pagesë, njëri nga Njësia Punuese e Prizrenit dhe një tjetër nga Njësia Punuese e Suharekës.
- Janë lëshuar shtatë Vërtetime për shtatë praktikant që kanë kryer punë praktike në Sektorin e Financave të Kompanisë.
- Në Zyrën Ligjore është pranuar një praktikante në kohëzgjatje prej tre muajsh.
- Gjatë muajit Shkurt është shpallur **1 (një)** Konkurs.
- Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesës së U.D. të Sekretarit të Kompanisë.
- **Aktivitete gjatë muajit Mars 2016**
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Sipas Kërkesës së parashtruar është marrë në punë 1 (një) punëtor me Kontratë për punë dhe detyra specifike.
- Gjatë muajit Mars janë shpallur **4 (katër)** Konkurse.
- Një punëtor e ka sjellë Diplomën e Bachelor-it.
- Me datë 25.03.2016, **1 (një)** punëtor i Njesisë Punuese të Prizrenit ka shkuar në pension të vjetërsisë.
- Me datë 18.03.2016 është bërë shkëputja e kontratës me punëtorin (B.H) – Arkatarë në Njësinë Punuese në Dragash.
- Janë bërë edhe punë tjera sipas kërkesës së U.D. të Sekretarit të Kompanisë.

4.1.2 PERSONELI – JANAR– MARS 2016

Muajt	Nr.i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Janar	308	3			2
Shkurt	311	3			3
Mars	315	4	1	1	2

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: MARS - 2016

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	261	37	6	11	315
Numri i Punëtorëve në %	82.9	11.7	1.9	3.5	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	37	11.75	
MESHKUJ:	278	88.25	
TOTAL	315		

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: MARS 2016

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsej
Nr. i punëtorëve	31	26	0	199	1	53	5	315
Kualifikimi në %	9.84	8.25	0.00	63.17	0.32	16.83	1.59	

4.1.3 RAPORTI I PUNËVE TE KRYERA NE GJYKATA JANAR – MARS 2016

Periudha raportuese	Padi	Përgjigje në padi	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruar nga Konsumatorët	Vendimet nga Kompania	TOTALI	Totali i lëndëve të ardhura nga Gjykatat
JANAR 2015	/	/	/	1	/	42	43	29
SHKURT 2015	1	1	1	1	/	49	53	7
MARS 2015	/	/	1	2	1	70	74	116
Totali	1	1	2	4	1	161	170	152

- Për tremujorin e parë të vitit 2016 nga Gjykata Themelore në Prizren janë sjellë tridhjetë e shtatë **(37) Aktvendime** sipas të cilave përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit Nr. 05/L – 043 për Faljen e Borxheve Publike.

- Gjykata Themelore në Prizren ka sjellë **URDHËR** me të cilin urdhërohet K.R.U. “Hidroregjioni Jugorë”Sh.A., me seli në Prizren, që në afat prej **8 (tetë) ditësh** të dërgoj në këtë Gjykatë Njoftim me shkrim lidhur me gjendjen e borxheve të reja për këto **92 (nëntë dhjetë e dy) lëndë**, në të kundërtën do ta përfundoj procedurën Përmbartimore të iniciuar nga ana e Kompanisë bazuar në Ligjin Nr. 05/L – 043 mbi Faljen e Borxheve Publike, pasi që borxhet në fjalë janë të Vitit 2008 e më të hershme.

- Për **6 (gjashtë)** lëndë nga gjykatat janë marrë **Vendime** në favor të Kompanisë sonë.

- Për **39 (tridhjetë e nëntë)** lëndë lidhur me Padit e ushtruara në periudha të ndryshme kohore nga Kompania jonë kundër debitorëve për borxhet e papaguara, gjykata ka marrë Aktvendime me të cilat e përfundon procedurën Përmbartimore të caktuar me përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit Nr. 05/L043 për Faljen e Borxheve Publike.
- Gjykata i ka parashtruar 92 (nëntëdhjetë e dy) Kërkesa për marrjen e informatave nga ne për gjendjen e borxheve të cilat i kanë këta konsumatorë konform Ligjin Nr. 05/L – 043 mbi Faljen e Borxheve Publike, ku në afatin e urdhëruar nga Gjykata neve jemi përgjigjur.
- Si pasojë e vdekjes së **1 (një) Konsumatori** Gjykata ka marrë Vendim sipas të cilit kjo çështje pushohet.
- Si pasojë e pamundësisë për tu siguruar adresa e saktë e një konsumatori Gjykata Themelore e Prizrenit me anë të Konkluzionit e çështjen juridike të përmbartimit në Lëndën E.nr. 1740/2010 e konsideron të përfunduar.

VENDIMET E KOMPANISË NË ANKESAT DHE KËRKESAT E KONSUMATORËVE

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti nga Kompania jonë janë lëshuar gjithsej 161 Vendime të cilat kanë të bëjnë me përgjigjet e dhëna në kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve.

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
Janar	42	
Shkurt	49	
Mars	70	
Totali	161	

Aktivite e Zyrarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë për TM-1 / 2016

Janar, 2016

- * Kontrollimi i aparateve kundër zjarrit në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A. si dhe kërkesa drejtuar organeve përgjegjëse për servisimin e aparateve.
- * Marrja e aparateve nga të gjitha njësitë për servisim, marrja është bërë përmes procesvebalit.
- * Dërgimi i shkresës për të gjitha njësitë për respektimin e masave mbrojtëse në punë dhe janë paisur me Formularët për defektet dhe Formularët për pranim-dorëzimin e detyrave të punës për rojtarët.
- * Vizita në objektet: Rezervari i Zhurit, Vermicës, Nashetit, 40 Burimet, Filtrat, si dhe tek Rezervari i Shpatit.
- * Kontrollimi i gjendjes të hidrantëve në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A. Prizren.
(Në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A. Prizren, i kemi tri hidrantë: Në Objektin e administratës në Kompani, Objektet e vjetra dhe tek Mulliri i vjetër, hidrantët janë funksional por u mungojnë gypat).
- * Është përpiluar lista e të gjithë rojtarëve nga të gjitha njësitë nëpër objektet ku bëhet kujdestaria me qëllim që të verifikohet se a e kanë kryer trajnimin e obligueshëm për mbrojtje nga zjarri të gjithë rojtarët.
- * Përmes firmës kontraktuese "ALFAGERR" në Prizren për servisimin e aparateve kemi marrë aparatet kundër zjarrit nëpër të gjitha Njësitë: Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash dhe është bërë servisimi i tyre sipas dokumentacionit të pranimit për 68 aparate.
- * Shpërndarja e aparateve kundër zjarrit sipas pranimit për servisim.

* **Njësia Prizren:** totali është - 39 aparate kundër zjarrit prej tyre 4 Aparatet nga 2kg. dhe 1kg. janë aparate për automjet-kamionëve.

* Në "Objekti i HRJ" janë 13 aparate, "Objektet e Vjetra" dhe Galerinë tek objektet e vjetra i kemi 8 aparate, te "Filtrat" i kemi gjithsej 5 aparate, te "Mulliri-Magazina" i kemi 5 aparate, te "40 Burimet" i kemi 2 aparate, te "Rezervari Shpati" e kemi 1 aparat, në "Zhurë" e kemi 1 aparat, në "Vërmicë" i kemi 2 aparate dhe tek objekti "Nashec" i kemi 2 aparate.

* **Njësia Malishevë** janë 15 aparate kundër zjarrit: "Objekti Malishevë" 5 aparate, në "Banjë Malishevë" 2 aparate, në "Damanekë" 2 aparate, në "Gurbardhë" 2 aparate, në "Shkozë" -1 aparate në "Maxharrë" 1 aparat, dhe në "Karvasari" 2 aparate.

* **Njësia Suharekë** janë 9 aparate kundër zjarrit: në "Baqevcë" 2 aparate, në "Pusi Atit" 1 aparat dhe tek "Objekti Suharekë" 6 aparate.

* **Njësia Dragash** janë 5 aparate kundër zjarrit: "Në zyrat e objekteve Dragash" 2 aparate dhe tek "Filtrat Dragash" 3 aparate.

Numri i aparateve kundër zjarrit në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A. në Prizren ka gjithsej 68 aparate të cilët janë të shpërndarë sipas raportit të përshkruar, njëherësh është specifikuar vendi i përshtatshëm për vendosjen e aparateve kundër zjarrit.

Shkurt, 2016

* Është bërë kontrollimi i të gjitha objekteve të Njesisë Punuese të Suharekës duke janë vizituar këto objekte: Pusi i Atit, objekti me rezervarët në Baqevcë, Kaptazhën në Savrovë, Rezervari në Semetishtë së bashku me stacionin e pompimit dhe kaptazhën, rezervari në Reshtan, rezervari i Dobërdolanit së bashku me objektin, rezervari dhe stacioni i pompimit në Samadrezhë, rezervari dhe stacioni i pompimit në Studenqan si dhe objektin e HRJ në Suharekë.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuese).

* Kontrollimi i të gjitha objekteve të Njesisë Punuese në Malishevë duke vizituar këto objekte: stacioni i pompimit në Banjë, stacioni pompimit Karvasari, Maxharrë, Shkozë, stacioni i pompimit në fsh. Burim, rezervarin dhe stacionin e pompimit në fsh.Gurbardh, nënstationin e pompimit Turjakë, Bubel, Damanek dhe Qupev, si dhe Objektin e HRJ në Malishevë.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuese).

* Vizita në objektet: 40 Burimet, Filtrat, Rezervari i Shpatit si dhe depot së bashku me objektet e vjetra që gjenden në hapësirën tek "Mulliri i vjetër".

